



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova
Komuna e Novobërdës
Opština Novo Brdo - Municipality of Novo Brdo

THIRRJE PUBLIKE

për angazhimin e një KONSULENTI / EKSPERTI për Vlerësimin Strategjik të Ndikimit në Mjedis.

Kryetari i Komunës së Novobërdës shpall **thirrje publike** për përzgjedhjen e kandidatëve për angazhimin e një **Konsulentit/Eksperti për Vlerësimin Strategjik të Ndikimit në Mjedis.**

1. Përshkrimi i pozitës

Konsulenti / Eksperti për Vlerësimin Strategjik të Ndikimit në Mjedis ofron mbështetje profesionale gjatë hartimit dhe analizës së vlerësimeve strategjike të ndikimit në mjedis për planet, programet dhe projektet që janë në kompetencë të Komunës.

2. Detyrat dhe përgjegjësitë

1. Pranon Draftin e PZHK-së nga A.K.
2. Përgatit raportin për Vlerësimin Strategjik të Ndikimit në Mjedis për dokumentin e planifikimit hapësinor – Planin Zhvillimor Komunal.
3. Kryen analiza në mënyrë profesionale dhe përgatit këtë raport.
4. Konsulenti është i obliguar të hartojë Vlerësimin Strategjik të Ndikimit në Mjedis deri në miratimin e dokumentit të planifikimit hapësinor nga ministritë përkatëse.
5. Raporton tek Menaxheri i kontratës.

3. Kapaciteti teknik dhe profesional

Kualifikimet për Konsulentin/Ekspertin për Vlerësimin Strategjik të Ndikimit në Mjedis:

- Master i shkencave në arkitekturë
- Të paktën 10 vite përvojë profesionale pune pas diplomimit
- Përvojë e dëshmuar në planifikim hapësinor
- Përvojë në hartimin e raporteve – Vlerësimi Strategjik i Ndikimit në Mjedis
- Duhet të jetë i licencuar nga institucionet vendore për hartimin e raporteve të Vlerësimit Strategjik të Ndikimit në Mjedis

Dokumentet e nevojshme:

- CV dhe dëshmi për kualifikimet;
- Letër motivuese;
- Referenca për përvojë pune pesëvjeçare në detyrat e ekspertit për vlerësimin e ndikimit në mjedis;
- Referenca që dëshmojnë përvojën në hartimin e raporteve të VSM;
- Licencë valide për Vlerësimin Strategjik të Ndikimit në Mjedis;
- Ofertë financiare për ofrimin e shërbimeve të ekspertit.

4. Kohëzgjatja e angazhimit

Angazhimi është i kufizuar në kohë dhe varet nga aktivitetet për të cilat është i nevojshëm Vlerësimi Strategjik i Ndikimit në Mjedis brenda planeve dhe programeve komunale.

5. Mënyra e aplikimit

Aplikimet dorëzohen në Qendrën për Shërbime ndaj Qytetarëve në Komunën e Novobërdës, në zarf të mbyllur, të adresuara për Zyrën e Kryetarit të Komunës.

Afati për dorëzimin e aplikimeve është 7 ditë nga data e shpalljes së këtij thirrjeje publike.

Shënim: Aplikimet e paplota ose të dorëzuara pas afatit nuk do të merren parasysh.

